



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2024/1075**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga zv.Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahim-Paneliste Individuale, duke vendosur sipas ankesës së (OE) “ARITECH”, kundër vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të “Komuna e Prishtinës” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ritender FURNIZIM ME KOMPJUTER PËR DREJTORINË E TRANSFORMIMIT DHE URBANIZMIT” me numër të prokurimit 616-24-9745-5-5-8, me 24/01/2025, mori:

### **Vendim**

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “ARITECH” me nr. 2024/1075, e datës 06/11/2024, kurse vendimi i AK “Komuna e Prishtinës” lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ritender FURNIZIM ME KOMPJUTER PËR DREJTORINË E TRANSFORMIMIT DHE URBANIZMIT” me numër të prokurimit 616-24-9745-5-5-8 anulohet B58 Njoftimi mbi vendimin e AK-së, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Arsyetim**

#### ***- Faktet dhe rrethanat procedurale -***

Autoriteti Kontraktues me datën 24.10.2024 Njoftimin mbi vendimin për dhënie te kontratës.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë sipas Kontratës Publike Kornize me nr. të ref; UA/2016-23-5755-1-1-1/C403 deri C420, Mini-tender lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 100,000.00 €.

Me 29.10.2024, OE “ARITECH” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 01.11.2024, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 06/11/2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “ARITECH” me nr. 2024/1075 për lidhur me aktivitetin “Ri-tender FURNIZIM ME KOMPJUTER PËR DREJTORINË E TRANSFORMIMIT DHE URBANIZMIT” me nr. të prokurimit: 616-24-9745-5-5-8.

### ***-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-***

OSHP -ja ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “ARITECH” janë parashtruar si në vijim:

Me date 24.10.2024 kemi pranuar Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues ka marr vendim qe te shpërblej me kontrate OE Ilir Kosova Shpk.

Ne kemi kërkuar qasje ne dokumente për OE- i cili mendohet te shpërblehet me kontrate.

Gjate analizës se ofertës teknike te OE qe mendohet te shpërblehet me kontrate kemi hasur qe ka vendosur broshure për pozicionin 1- Brand Name PC - Model IV OE Ilir Kosova Shpk ka ofertuar me modelin HP Elite Tower 800 G9.

Për te njëjtën ka vendosur broshurën e prodhuesit, e cila nuk e plotëson specifikimin teknik.

Modeli HP Elite Tower 800 G9 nuk e përkrah kartelën grafike 16GB ashtu siç kërkohet ne dosje te tenderit.

OE Ilir Kosova ne ofertën teknike ka vendosur kartelet grafike jashtë broshurës se prodhuesit, siç shihet me poshtë:

Shih printscreen tek formati PDF.

Kartela Grafike e ofruar nga OE Ilir Kosova është:

ASUS Dual Radeon™ RX 7600 XT OC Edition 16GB GDDR6

Linku:<https://www.asus.com/motherboards-components/graphics-cards/dual/dual-rx7600xt016g/techspec/>

Ne broshure te prodhuesit gjenden modelet e prodhuesit, te cilat rekomandohen dhe përkrahen nga prodhuesi (arkitektura e PC- Elite Tower 800 G9):

Shih printscreen tek formati PDF.

Modeli i ofertuar përkrah grafike max 12GB, e cila është specifikuar ne broshure te prodhuesit.

Kërkesa nga AK ka qene për model Brand Name, ndërsa broshura për këtë model Brand

Name nuk ka kartelet Grafike 16GB, prandaj konsiderojmë qe produkti nuk e plotëson specifikimin teknik te kërkuar ne dosje te tenderit.

Brand Name nënkupton qe produktet te jene nga prodhuesi, e definuar qarte ne broshure, çdo devijim prej broshure, duke intervenuar ne produkt e humb kuptimin e Brand Name.

Përveç kësaj Grafika e ofertuar nga OE qe mendohet te shpërblehet me kontrate nuk është ne përputhje me rekomandimet për power supply.

Arkitektura e series HP Elite nuk është ndërtuar ne atë mënyre qe te suportoj kartelet grafike 16GB, përveç pjesës se funksionalitetit optimal te grafikes ky model power supply maksimal qe ka ne konfigurim është 550W, ndërkohë qe ajo minimale për funksion optimal te kartelës grafike ne fjale nevojitet powersupply 600W .

Shih Printscreen ne formatin PDF.

Këto argumente dhe kërkesa te cilat kane qene nga AK ka bere qe ne si OE te ofertojmë me seri HP – Z series , seri e cila përkrah dhe plotëson kërkesat nga AK, rrjedhimisht ka edhe kosto me te larte.

Ne lidhje me Monitorin (Monitor AOC Q32P2 ) me aq sa dimë ne si OE paraprakisht nuk ka qene asnjë OE i para kualifikuar me këtë brend tek kontrata baze me AQP, përveç ne rast se janë ngarkuar ndërkohë nga ndonjë OE i para kualifikuar, mirëpo kjo mbetet te verifikohet nga ju si AK për secilin brand nëse OE-te kane MAF apo DAF përkatës.

AK nuk ka komentuar fare rreth Autorizimit nga prodhuesi AOC, kërkojmë nga Organi shqyrtues te kërkojë nga AK verifikim rreth Autorizimit për OE qe është menduar te shpërblehet me kontrate, te shihet nëse ka te ngarkuar ne sistem te e-prokurimit Autorizim nga prodhuesi AOC.

AK lidhur me refuzimin e kërkesës për Rishqyrtim nuk ofron asnjë argument për refuzim te kërkesës.

Ne kemi paraqitur fakt broshuren e prodhuesit ku shihet qarte maximumi I Grafikes 12GB qe mund te përkrah Modeli HP Elite tower 800 G9 i ofruar nga OE Ilir Kosova.

AK nuk e kundërshton me fakte këtë argument, por vetëm refuzon.

Ndërsa lidhur me faktin shtese qe kemi paraqitur rreth Grafikes ASUS, rreth kapacitetit te Power Supply qe kërkon Grafika, përsëri refuzon, duke theksuar qe ska qene kërkesë ne dosje te tenderit.

Ne nuk kemi paraqitur atë si kërkesë ne dosje por si argument shtese te mospërputhjes me produktin , megjithëse ne këtë rast nuk ka fare rendësi, sepse prodhuesi ne broshure ka evidentuar kartelat Grafike te caktuara, por jo Grafike me kapacitet 16GB.

Specifikimi teknik dhe broshura është e definuar me kontrate te AQP-se.

Ne jemi te habitur nga Refuzimi i AK-se, duke mos shqyrtuar fare argumentet e paraqitura nga broshura e prodhuesit rreth Grafikes 16GB, e cila nuk gjendet fare ne broshure!

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “ARITECH” konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, 7, 59 te LPP-së. Kërkojmë nga Organi shqyrtues i prokurimit qe te vendos si ne vijim: APROVOHET si e bazuar Ankesa e OE “ARITECH SHPK” lidhur me tenderin “Ri tender FURNIZIM ME KOMPJUTER PËR DREJTORINË E TRANSFORMIMIT DHE URBANIZMIT” me nr. Prokurimi 616-24-9745-5-5-8 ANULOHET Aktiviteti i prokurimit i kësaj lende , nga “KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES”, te kërkohet nga AK qe te anuloj Vendimin e tij, te kthej lenden ne Rivlerësim. Vlerësimi i ofertave te behet duke respektuar te gjitha kriteret teknike.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se kërkesa për të cilën bëhet fjalë është si në vijim

Komisioni vlerësues i përbërë nga anëtarë profesional të fushës pas ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit me kujdes të ofertës së tenderuesit të rekomanduar ka gjetur se produktet me të cilat ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar i plotësojnë kushtet për punë në drejtorinë përkatëse si dhe e përkrahin kartelën grafike min. 16 GB GDDR6 sikurse është kërkuar në ftesë/dosje. Në anën tjetër parashtruesi nuk ka prezantuar ndonjë argument të qëndrueshëm sipas të cilit do të argumentonte arsyen pse produktet e tenderuesit të rekomanduar nuk përkrahin kartelën grafike min. 16 GB. Ndërsa sa i përket pjesës së pretendimit ankimor ku parashtruesi citon nga interneti disa rekomandime për power supply të kartelës grafike, duhet cekur se kjo nuk ka qenë kërkesë e dosjes/ftesës dhe nuk mund të trajtohet si pretendim.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 07.11.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1075/2024, ndërsa me datë 26.11.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/1075 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e mësipërme, Eksperti Shqyrtues dhe Teknik i rekomandojnë Panelit Shqyrtues që ankesa të aprovohet si pjesërisht e bazuar. Më tej rekomandohet që të anulohet vendimi i AK-së dhe aktiviteti të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

#### ***- Administrimi dhe vlerësimi i provave –***

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “ARITECH”- eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/1075 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim hyrës: Parashtruesi i ankesës – ARITECH SHPK Graçanicë ( më tej OE ankues) ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së me datë 29.10.2024, përderisa AK me datë 04.11.2024 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

Pretendimi ankimor 1

OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së dhe nenin 40 të RrPP duke rekomanduar për shpërbllim me kontratë OE që ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme.

Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 1

AK, në dosjen e tenderit ( Ftesën për Ofertim-FPO) tek Aneksi 1, ka përcaktuar specifikimet teknike, ku tek pozicioni 1- Kartela Grafike: është kërkuar “min.16 Gb GDDR6, dy porte: HDMI+DP (16Gb minimumi që i plotëson kushtet për punë në drejtoritë e Transformimit dhe Urbanizmit)”

Në fazën e sqarimeve lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, një OE kishte kërkuar sqarime lidhur me këtë pozicion si vijon: “Pyetja 1.2: Keni kërkuar: Kartela Grafike: min.16 GB GDDR6, dy porte: HDMI+DP (16Gb minimumi që i plotëson kushtet për punë në drejtoritë e Transformimit

dhe Urbanizmit): Kërkojmë të jene të pranueshme kartela grafike 16GB me 4\*mDP duke pas parasysh se tek modelet e reja kartelat grafike të konfiguroshme prej prodhuesit kanë kaluar në output mDP për shkak të hapësirës së kufizuar në dalje për 4 porte HDMI ose DP, të cilat kanë dimensione më të mëdha. Për plotësimin e nevojave tuaja për HDMT+DP,ju lutem të na lejohet ofertimi i konverteve mDP-to-HDMI apo mDP-to-DP në varësi prej Monitorit që ofertohe (në pozicionin nr 2).” Ndërsa AK me datë 25.10.2024 ishte përgjigjur si vijon: “Pika 1.1: Kartela Grafike Përgjigje: Kërkesa për kartelën grafike është e qartë dhe duhet të respektohet në përputhje me specifikimet e kërkuara. Kartelat grafike duhet të jenë të certifikuar nga prodhuesi për të siguruar funksionalitetin dhe për të shmangur probleme të mundshme me pajisjet. Pra, çdo ndryshim në këtë pikë nuk është i pranueshëm.”

Të njëjtin pretendim ankimor, OE ankues e kishte dhënë në kërkesën për rishqyrtim të paraqitur në AK me datë 29.10.2024. AK në lidhje me këtë pretendim, në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të datës 04.11.2024, ka dhënë arsyetimin si vijon: “Komisioni vlerësues i përbërë nga anetare profesional të fushës pas ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit me kujdes të ofertës së tenderuesit të rekomanduar ka gjetur se produktet me të cilat ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar i plotësojnë kushtet për punë në drejtorinë përkatëse si dhe e përkrahin kartelën grafike min. 16 GB GDDR6 sikurse është kërkuar në ftesë/ dosje. Në anën tjetër parashtuesi nuk ka prezantuar ndonjë argument të qëndrueshëm sipas të cilit do të argumentonte arsyen pse produktet e tenderuesit të rekomanduar nuk përkrahin kartelën grafike min. 16 GB. Ndërsa sa i përket pjesës së pretendimit ankimor ku parashtuesi citon nga interneti disa rekomandime për power supply të kartelës grafike, duhet cekur se kjo nuk ka qenë kërkesë e dosjes/ftesës dhe nuk mund të trajtohet si pretendim. Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtuesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtuesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.”

Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 1

Eksperti sqaron fillimisht se AK në FPO kishte kërkuar deklaratën për përmbushjen e specifikacioneve teknike dhe në Aneksin 1 kishte përcaktuar specifikimet teknike minimale për pozicionin 1, ndër të tjera për kartelën grafike. OE sipas dëshmive të dorëzuar me ofertë ka ofertuar me produktin HP Elite Tower 800 G9 R dhe kartelën grafike “DUAL-RX7600XT 16 Gb GDDR6”, gjë që është plotësuar specifikimi minimal i kërkuar, rrjedhimisht AK në këtë pikë ka bërë vlerësimin në pajtim me paragrafin 4 të nenit 59 të LPP-së. Më tej lidhur me pjesën ku OE ankues pretendon se “Brand Name nenkupton që produktet të jene nga prodhuesi, e definuar qartë në broshurë, çdo devijim prej broshurë, duke intervenuar në produkt e humb kuptimin e Brand Name”, pretendimi është i paqëndrueshëm, duke marrë për bazë përcaktimin e paragrafit 4 të nenit 59 ku thuhet se AK do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. AK në FPO nuk kishte kërkuar broshurë apo katalog në lidhje me pajisjet e ofertuar. Rrjedhimisht pretendimi se në broshurën e pajisjes së ofertuar nuk paraqitet kartela grafike e ofertuar është pretendim i pabazuar.

Pretendimi ankimor 2; OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së dhe nenin 40 të RrPP duke rekomanduar për shpërblim me kontratë OE që ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, pasi që nuk ka dorëzuar autorizimin për brendin “AOC” të ofertuar për pozicionin 2.

Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 2

Ky aktivitet është zhvilluar si procedurë e mini-konkurrencës, duke u bazuar në Marrëveshjen Kornizë për Furnizim me Pajisje të Teknologjisë Informative me numër të identifikimit: UA/2016-23-5755-1-1-1/C403 deri C420, të lidhur në mes të Agjencisë Qendrore të Prokurimit (AQP) dhe 18 OE-ve, të cilët janë të parakualifikuar.

Në paragrafin 2 të nenit 6 të Marrëveshjes Publike Kornizë, përcaktohet: “Operatoret Ekonomik që janë palë e kësaj marrëveshje duhet të njoftojnë Agjencinë Qendrore të Prokurimit nëse marrin autorizim të ri nga prodhues të tjerë (nëse shtojnë numrin e autorizimeve apo nëse e ndryshojnë autorizimin). Pa autorizim valid ose pa e njoftuar Agjencinë Qendrore të Prokurimit Operatoret Ekonomik nuk kanë të drejt të aplikojnë në fazën e mini-tenderëve.”

OE i rekomanduar ( Ilir Kosova Sh.p.k) në dokumentin e dorëzuar me ofertë, të titulluar “Oferta Teknike” ndër të tjera shënon se për pozicionin 2 oferton me produktin “AOC Q32P2”.

Me datë 25.11.2024, është kërkuar informacion nga AQP në lidhje me autorizimet dhe në të njëjtën ditë AQP është përgjigjur si vijon: “Ju informoj që OE Ilir Kosova Sh.p.k , PRISHTINË me ofertën e tij për aktivitetin e prokurimit: Furnizim me Pajisje të Teknologjisë Informative me nr. UA/2016-23-5755-1-1-1 ka dorëzuar autorizime për: Dell, HP, Lenovo, Fujitsu. Ndërsa ky OE nuk ka dorëzuar ndonjë autorizim tjetër sipas nenit 6.2 të marrëveshjes kornizë”

Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 2

Sipas sqarimeve të mësipërme, marrëveshja publike kornizë në bazë të cilës është zhvilluar procedura për mini tenderim, përkatësisht është dërguar FPO tek OE-të e parakualifikuar, ka përcaktuar se OE-të duhet të kenë të dorëzuar paraprakisht autorizimin e prodhuesit në AQP në mënyrë që më pas të mund të ofertojnë. OE i rekomanduar ka ofertuar me produktin e prodhuesit “AOC” për të cilin nuk kishte dorëzuar autorizim paraprak në AQP, rrjedhimisht pretendimi ankimor është i bazuar.

#### ***- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –***

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues/teknik, i hartuar me kërkesën e OSHP-së lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga ekspertët që ta shqyrtojnë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore për nevojat e Panelit dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe

vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e raportit të ekspertit shqyrtues/teknik vlerësimet e tyre janë të pranueshme dhe , mirpo për të vërtetuar saktësin e pretendimit ankimor nr 2 lidhur me OE I rekomanduar nga ana e AK-se ku ka ofruar produktin me brendin AOE, PSH ka kerkuar nga AQP-ja si nenshkruese e marrveshjes kornize ( mini-tender ) lidhur me furnizimin me pajisje te IT-se, se OE i rekomanduar I.K , pjesmares i marveshjes a ka ofruar autorizimin e sipërmendur dhe përgjigja e ofruar nga AQP citohet “ OE: Ilir Kosova ka dorëzuar autorizimin e HP se bashku me oferte. Ndërsa me datën 02.12.2024 ka dorëzuar autorizimin për AOC, bazuar ne nenin 6.2 të marrëveshjes kornize i njëjti ka te drejt te ofertoj me këto produkte vetëm pas datës 02.12.2024.

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues pas pranimit te pergjigjes nga AQP-ja, ku kjo procedur ka filluar me datën: 18.09.2024, me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tyre me rastin e vendosjes, në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “ARITECH” janë pjesërisht të bazuara.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura ka vendosur që aktiviteti i prokurimit me “Ri-tender FURNIZIM ME KOMPJUTER PËR DREJTORINË E TRANSFORMIMIT DHE URBANIZMIT” me nr. të prokurimit: 616-24-9745-5-5-8, të kthehet në rivlerësim, dhe gjatë rivlersimit AK të veproj në raport me dispozitat ligjore të LPP-së.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I,II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.





Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Batisha Ibrahim**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - ARITECH**
- Arkivës së OSHP-së: